



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 218, datë 28.12.2017

**MBI
AUDITIMIN E VEPRIMTARISË SË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes së BSHS, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimeve të BSHS ndër vite, duke filluar nga viti 2001 e në vazhdim, si dhe detyrimet për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim, konsideron të nevojshëm përzgjedhjen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS, e një shoqërie auditimi ndërkombëtare. Kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme nga ana e Autoritetit, e cila nuk është realizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të procedojë brenda datës 31.01.2018, me përzgjedhjen e shoqërisë audituese ndërkombëtare me qëllim auditimin e veprimtarisë së BSHS që lidhet me gjithë detyrimet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.
2. Objekti i Auditimit, përveç të tjerave, të jetë edhe për:

- a) Verifikimi i gjendjes së databazës për dëmet e paguara dhe dëmet e papaguara në 31.12.2017, si për dëmet me datë ngjarjeje deri në datën 31.12.2013 ashtu edhe për dëmet me datë ngjarjeje pas datës 01.01.2014;
 - b) Përcaktimi i saktë i detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi deri në datën 31.12.2013;
 - c) Përcaktimi i saktë i detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi pas datës 01.01.2014;
 - d) Analiza për faktorët e rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura (të paguara dhe të papaguara) në 31.12.2017 krahasuar me gjendjen në datën 31.12.2013 duke u fokusuar edhe në dëmet në proces gjyqësor si dëme me vlera të larta;
 - e) Verifikimi nëse në databazën e dëmeve të paguara qëndrojnë ende dëme të cilat janë paguar;
 - f) Përputhja e vlerave të dëmeve me pasqyrat financiare të BSHS;
 - g) Gjendja e padive të regresit.
3. Periudha e auditimit të jetë nga 01.01.2001 deri në 31.12.2017.
 4. Raporti i auditimit të dorëzohet pranë Autoritetit brenda datës 31.03.2018.
 5. Byroja Shqiptare e Sigurimit njofton në Autoritet shoqërinë audituese të përzgjedhur brenda 3 ditëve nga data e përzgjedhjes së shoqërisë.
 6. Ngarkohen Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI